



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 637/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për apelin e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it Anr. 389/2010 të datës 12.12.2010, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si i pabazuara apeli i subjektit politik Fryma e Re (FER), për rishqyrtimin e vendimit të PZAP-t, Anr. 389/2010 të datës 12.12.2010.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një apel më datë 15.12.2010, nga subjekti politik FER, me te cilën pretendohet se PZAP-i në vendimin më Anr. 389/2010 të datës 12.12.2010, nuk mori parasysh përgjigjen në ankesë edhe pse ky subjekt politik është përgjigjur në ankesë brenda kohës së caktuar nga PZAP-i. Në përgjigje ndaj ankesës me Anr. 389/2010 të datës 10.12.2010 nga subjekti politik FER, është theksuar se nuk kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore ngase nuk kanë ngjitur postera mbi posterat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) siç pretendohet në ankesë. Subjekti politik FER potencon se e kanë vendosur një baner mobil pranë derës së hyrjes tek Qendra e Kulturës ku kanë mbajtur tubim më elektorat më datë 08.12.2010. Baneri mobil ka qenë i vendosur aty përkohësisht për një periudhë rreth 30 minuta sa për t'i informuar qytetarët për vendin ku do të mbahet tubimi. Pas përfundimit të tubimit elektorat baneri në fjalë është tërhequr dhe nuk ka pasur asnjë pengesë për pamjen e posterit të subjektit politik PDK.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë materiale.

Vendim i PZAP-it Anr. 389 të datës 12.12.2010, është marrë në bazë të dispozitave ligjore të Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Neni 118 paragrafi 4 i LZP-së parasheh;

118.4 Mund të apelohet vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuara.

Pretendimet nga parashtruesi i apelit, se nuk është marrë në konsiderim përgjigjja në ankesën Anr. 389 e datës 09.12.2010 nga PZAP-i, ngase edhe në të kundërtën nuk ka qenë e asaj natyre që të merret si rrethanë lehtësuese që do të kishte ndikim në vendimmarrje sepse parashtruesi i përgjigjes në ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të besuar se subjekti politik FER ka bërë përpjekje serioze për të evituar shkeljen e bërë.

Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e lartcekura e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 637/2010 më datën 23.12.2010.

